

THE CHALLENGES AND THE CONTEXT OF THE USE OF ALBANIAN LANGUAGE IN NORTH MACEDONIA AFTER OHRID FRAMEWORK AGREEMENT

Teuta Arifi

Faculty of Philology, UKIM, Skopje, North Macedonia, teutarifi@gmail.com

Abstract: The purpose of the paper is to explain some aspects regarding the official use of the Albanian language in North Macedonia, having in mind that it became an official language initially with the signing of the Ohrid Framework Agreement in 2001, followed by amendments to the Constitution of the country during the same year, and followed by the adoption of the Law on the use of languages in 2008 and the Law on the use of languages of 2018 which is still in force. The Albanian language constitutes the basic identity element of the Albanian population in North Macedonia and as such was part of the Ohrid Agreement which ended the armed conflict in 2001, a political agreement which addressed a wide range of issues related to ethnic identity, which after the constitutional amendments of 2001, took on an institutional character. The paper follows an explanatory line of this Agreement regarding the use of the Albanian language, as well as the circumstances and the evolving process of translation into concrete laws for the use of the language in the spirit of the Ohrid Framework Agreement. I underline the term evolutionary process, always bearing in mind the fact that the other ethnic issues addressed in the Ohrid Framework Agreement were transformed into laws much earlier than the issue of the official use of the Albanian language, and this development is dedicated to the fact that during the implementation process of the Agreement priority was been given to issues which had a higher potential for conflict, such as ethnic representation in security forces (policy and army), while the official use of the Albanian language in a wide spectrum was treated as a matter that could be discussed and implemented later. The process of the legal regulation of the official use of the Albanian language began in 2008 and was completed with the Law on the Use of Languages of 2018, which includes the use of the Albanian language at the central levels of legislation, including executive, judicial and local institutions. Being a law with a wide scope of action, the interest of this paper are also the challenges faced by the implementation of this law in practice, always bearing in mind the existing institutional capacities of the institutions responsible for implementing this law in the everyday life of the citizens of the country. Overcoming these challenges remains a matter of identity, but also a matter of special developmental importance when we consider the fact that the equal use of languages constitutes the essence of the European values of equality and progress.

Keywords: mother tongue, linguistic equality, identity, institution, agreement;

KONTEKSTI DHE SFIDAT REALE RRETH PËRDORIMIT ZYRTAR TË GJUHËS SHQIPE NË MAQEDONINË E VERIUT PAS MARRËVESHJES KORNIZË TË OHRIT

Teuta Arifi

Fakulteti Filologjik, USHKM, Shkup, teutarifi@gmail.com

Abstrakt: Punimi ka për qëllim shpjegimin e disa aspekteve sa i përket përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut, gjuhë kjo e cila u bë pjesë e përdorimit zyrtar fillimisht me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit në vitin 2001 dhe që u pasua nga ndryshimet e kushtetutës së vendit po këtë vit, për të vazhduar më tej me aprovimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në vitin 2008 dhe Ligjin për përdorim të gjuhëve të vitit 2018 i cili është akoma në fuqi. Gjuha shqipe përbën elementin themelor identitar të popullatës shqiptare në Maqedoninë e Veriut dhe si e tillë ishte edhe pjesë e Marrëveshjes së Ohrit e cila i dha fund konfliktit të armatosur të vitit 2001, si marrëveshje politike e cila adresoi pako të gjerë të çështjeve të lidhura me identitetin etnik, çështje këto të cilat pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2001, muarën karakter institucional. Punimi ndjek një linjë shpjeguese të kësaj Marrëveshjeje sa i përket përdorimit të gjuhës shqipe, si dhe rrethanat dhe procesin evolutiv të përkthimit në ligje konkrete për përdorimin e gjuhës të vetë frymës së Marrëveshjes së Ohrit. Nënvizoj termin proces evolutiv duke pasur gjithnjë në konsiderim faktin që çështjet e tjera etnike të adresuara në Marrëveshjen e Ohrit u transformuan në ligje shumë më herët se sa aspekti i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe dhe ky zhvillim i dedikohet faktit që gjatë procesit implementues të Marrëveshjes përparësi kishin çështjet të cilat kishin potencial më të lartë të konfliktit si përfaqësimi etnik në organet e sigurisë, ndërkohë që çështja e përdorimit zyrtar të gjuhës në spektër të gjerë, trajtohej si çështje e cila mundej të diskutohej dhe implementohej më vonë. Procesi i rregullimit me ligj të përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe filloi në vitin 2008 për të arritur në Ligjin për përdorimin e gjuhëve të vitit 2018, i cili përfshin përdorim të gjuhës shqipe në nivelet qendrore të pushtetit legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor dhe vendor.

Duke qenë një ligj me sferë të gjerë veprimi interes i këtij punimi janë edhe sfidat me të cilat përballët jetësimi në praktikë i këtij ligji, gjithnjë duke pasur parasysh kapacitetet eksistuese institucionale për të bërë të mundshme që ky ligj të jetë pjesë e përditshmërisë dhe jetës së qytetarëve në vend. Tejkalimi i këtyre sfidave mbetet sa një çështje identitare, po aqë edhe një çështje e rëndësie të veçantë zhvillimore kur kemi parasysh faktin që përdorimi i barabartë i gjuhëve përbën thelbin e vlerave europiane të barazisë dhe përparimit.

Termat kyçe: *gjuhë amtare, barazi gjuhësore, identitet, institucion, marrëveshje;*

1. SHËNIME HYRËSE: ZYRTARITETI GJUHËSOR, NJË NIVEL I RI I PËRDORIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut përbën njërin nga faktet kyçe të zhvillimit të identitetit politik si shqiptarë në këtë vend, por në të njëjtën kohë në kuptimin e teorive shoqërore dhe politike përfaqëson atë moment kyç të zyrtarizimit të identitetit dhe kalimit nga një identitet të mbrojtur nga traditat kolektive popullore, në një identitet, garantues i të cilit tanimë bëhen institucionet shtetërore. Nga ajo arsye shumë e thjeshtë që kombi përbën atë kategori sociopolitike pandashmërisht të lidhur me mundësitë dhe fuqitë e një shteti, ndërkohë që një bashkësi etnike përbën atë kategori kulturore e cila konservon identitetin në mënyrë tradicionale brez pas brezi pa pasur linkun apo përmbajtjen e institucioneve shtetërore. (Balibar&Wallerstein, 2000:79). Dhe duke ndjekur këtë logjikë shpjeguese, përqëndrimi i aktivizmit identitar-gjuhësor të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut ndjek konceptin e formimit identitar të popujve të Europës, të cilët kanë kanë kalitur identitetin e tyre të bazuar mbi vijat kulturore thellë të rrënjësura në gjuhët e tyre (Hagege, 1992:228). Në këtë drejtim gjuha shqipe mbetet identifikimi parësor tek shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, i ndërë dhe i kuptuar si trashëgimia e përbashkët që identifikon një bashkësi etnike (Horovitz, 1985:56). Shikuar në këtë kuptim, rregullimi kushtetues dhe ligjor i kësaj çështjeje ishte dhe vazhdon të mbetet një proces sa dinamik po aqë edhe strategjikisht i rëndësishëm, jo vetëm për shqiptarët, por edhe për vetë shtetin duke pasur parasysh dokumentet, konventat dhe politikat europiane sa i përket përdorimit të më shumë gjuhëve në funksionimin e shtetit dhe organeve shtetërore, arsimor e kulturore.

Duke u njohur si një vijë e theksuar identitare, gjuha shqipe shfaqet si subjekt që në dokumentet e para të Maqedonisë Socialiste, për të vazhduar më tej me tekstet kushtetuese të viteve 1974 dhe 1989. Qasja ndaj gjuhës shqipe në këto dokumente dëshmon për mënyrën e trajtimit të të drejtave kolektive-etnike brenda Federatës Jugosllave në përgjithësi dhe rrjedhimisht brenda njërive federale, në këtë rast Maqedonia Socialiste në veçanti. Përbrenda Federatës Jugosllave ndodh edhe një ndarje tjetër e popullatës shqiptare, e cila tani jeton në më shumë njësi federative veçmas nga Krahina e atëhershme Socialiste e Kosovës dhe si rezultat edhe përdorimi i gjuhës shqipe në institucione dhe rregullimi ligjor i saj dallon në varësi të asaj se në cilën njësi federative kjo gjuhë do të duhej të ishte në përdorim zyrtar. Çështjet etnike dhe kombëtare përbrenda Federatës Jugosllave do të mbeten në një gjendje hibernacioni, gjithnjë duke pasur parasysh faktin që në kuptimin formal kjo Federatë mëtonte të ishte një bashkim socialist i kombeve të ndryshëm të cilët i bashkonte ideologjia social-komuniste, ideologji kjo e cila duhej që fuqishëm dhe me primatin e saj të suprimonte identitetin etnik si një identitet parësor të popujve të ballkanit që nga shekulli i XIX-të. Ishte kjo ideologji e cila mbuloi konfliktin e përhershëm ndërmjet homogjenizimit dhe diversitetit etnik, ndërmjet asimilimit dhe pluralizimit. (Banac, 1984:22). Ky koncept kishte edhe amplitudat e veta varësisht nga trendi politik në nivel federativ, që shpjegon faktin që elementi identitar-gjuhësor është më pak i shprehur në tekstet kushtetuese para vitit 1974, për të vazhduar me një terminologji shumë më kohezive sa i përket përdorimit të gjuhës në kushtetutën e vitit 1974 dhe për të përfunduar me restriksion të plotë ndaj të drejtave gjuhësore me ndryshimet kushtetuese të vitit 1989.

Këtë koncept restriktiv në kuptimin e identitetit etno-gjuhësor ndjek edhe shteti i Maqedonisë si një shtet i ri i cili del nga shpërndarja e Federatës Jugosllave dhe si një shtet në fillimet e veta ndjek një koncept restriktiv ndaj pranisë së vlerave identitare shqiptare duke i përjashtuar të njëjtat si nga teksti kushtetues i cili nuk u përkrah nga deputetët shqiptarë në përbërjen parlamentare të vitit 1991, dhe poashtu nga tekstet legislative për përdorimin e gjuhës në institucionet shtetërore dhe në shkollimin universitar. Edhe përkundër më shumë rekomandimeve ndërkombëtare veçanërisht atyre të Komisarit të Lartë të OSBE-së për Minoritetet, i cili adreson çështjen e përdorimit të gjuhës shqipe deri tek autoritetet shtetërore të Maqedonisë në vitet e 90', duke kërkuar qasje më liberale për përdorimin e gjuhës shqipe veçanërisht në shkollimin e lartë, megjithatë asokohe mungoi vullneti politik tek shumica etnike-politike maqedonase, gjë që rezultoi me konfliktin e armatosur dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit, Marrëveshje kjo e cila ridefinoi shtetin në kuptimin e ndarjes së fuqisë mes bashkësive të ndryshme etnike. (Andeva, Sela, Matovski, 2022:3).

2. MARRËVESHJA KORNIZË E OHRIT: SFIDAT E PRAKTIKIMIT TË DYGJUHËSISË, NGA GJUHA E FOLUR TEK GJUHA E SHKRUAR

Duke u nisur nga kjo premisë e rëndësishme teorike do të ishte konstatim i padiskutueshëm që Marrëveshja Kornizë e Ohrit është dokumenti i cili vendos në korniza shtetërore përdorimin e gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut, gjithnjë sipas standardeve të shqipes letrare dhe drejtshkrimit të saj nga viti 1972. Apo siç do të kuptohet nga kjo analizë, Marrëveshja e Ohrit propozonte një varg të reformave kushtetuese dhe institucionale të disajnuara për të reduktuar asimetrinë mes shumicës maqedonase dhe bashkësisë etnike shqiptare në fushën e gjuhës dhe përfaqësimit në sektorin publik dhe atë politik si dhe balansimin e ndikimit dhe të drejtave kolektive sa i përket decentralizimit dhe arsimit (Ragaru, 2008:10). Seksioni nr.6 i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në fakt definon në mënyrë të ndërlidhur zbatimin e gjuhëve dhe arsimimin shqip në të gjitha nivelet si një binom i pandashëm, duke pasur parasysh realitetin objektiv që përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe është i lidhur ngushtë me mundësitë akademike për shkollim të lartë, si dhe me kapacitetet e nevojshme për të implementuar këtë pjesë të Marrëveshjes. (OFA, 2001:6). Sferat e parapara nga Marrëveshja e Ohrit sa i përket përdorimit të gjuhës shqipe janë të gjëra nëse të njëjtat i analizojmë përkrah investimet serioze që duheshin bërë me qëllim që e shkruara të bëhej sa më shpejtë një përditshmëri e zakonshme. Me marrëveshjen sanksionohet zyrtariteti i gjuhës (i identifikuar si gjuha e bashkësisë që përbën mbi 20% të popullatës së përgjithëshme); komunikimi me organet e pushtetit qendror, qeverisjen vendore, pjesë të procedurave gjyqësore si dhe dokumentet personale të qytetarëve. (OFA, 2001:6.5).

Gjatë analizave dhe shkrimeve që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut, nuk duhet të harrojmë faktin që definimi i përdorimit të saj është bërë në një marrëveshje paqësore që kishte për qëllim ndërprerjen e konfliktit të armatosur, por që legjitimitimi i kësaj gjuhe brenda kushtetutës dhe veçanërisht ligjeve përkatëse, do të bëhej në situata të paqes dhe procedurave parlamentare (OFA, 2001:5). Poashtu sipas marrëveshjes së nënshkruar në Ohër, ishte përbërja parlamentare 1998-2002 ajo e cila votoi ndryshimet kushtetuese konform Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, ndërkohë që përbërja parlamentare në vijim (2002-2006), sipas Aneksit B të kësaj Marrëveshjeje, duhej që të votonte ndryshimet ligjore konform kushtetutës tanimë të ndryshuar sipas Marrëveshjes së Ohrit.

Nëse koha është relative sipas teorisë fizike të relativitetit, atëherë koha politike është përtej kësaj teorie. Asnjë forcë nuk ka fuqinë e kohës si forca më aktive e cila formëson kuptimin tonë të jetës politike dhe na bën të thellojmë të kuptuarit tonë të dinamikave komplekse politike si dhe të përmirësojmë teorinë dhe metodat me të cilat interpretojmë politika të caktuara – do të theksojë Shapiro (Shapiro, 2016:32). Ky koncept i kohës politike mbase do ishte shpjegimi për faktin që edhe pse sipas Marrëveshjes së Ohrit ishte paraparë që ndryshimet kushtetuese të kalonin procedurat parlamentare në periudhë më të shkurtër kohore, megjithatë debati dhe atmosfera e parlamentit të atëhershëm rezultoi me disa intervenime nga teksti i parë i propozuar, ashtu siç edhe procedurat për ndryshimin e ligjeve muarrën më shumë kohë varësisht nga negociatat mes subjekteve politike gjithnjë të ndihmuara nga përfaqësuesi i posaçëm i BE dhe ambasadori i SHBA në rol të përfaqësuesit të posaçëm për këto çeshtje.

Nëse përdorimi i gjuhës shqipe në formën zyrtare përbënte njëri ndër pikat më vështirë të negociuara të Marrëveshjes së Ohrit, jetësimi i pikërisht kësaj pjese ishte dhe vazhdon të mbetet sfida institucionale dhe shkencore. Prandaj edhe Marrëveshja e Ohrit ishte dhe mbetet një marrëveshje kornizë, pra një dokument që vendos kornizat e vullnetit të dakorduar politik për një çeshtje, pra në këtë rast të përdorimit të gjuhës, por në vehte përbën një rrugë e gjatë për të vendosur dhe qartësuar vijat ligjore dhe institucionale të përdorimit të një gjuhe në nivel shtetëror.

Praktikat e përdorimit të gjuhës shqipe dhe drejtshkrimit të saj ndjekin një vijë të ngadalshme të sistemimit zyrtar gjatë dekadës së parë të jetësimit të Marrëveshjes së Ohrit në praktikat shtetërore dhe në shoqërinë në përgjithësi, dhe kjo kryesisht i dedikohet faktit që gjatë viteve të para të realizimit dhe vendosjes në praktikë të ndryshimeve kushtetuese ishin çeshtjet e sigurisë dhe balansimit të numrit të qytetarëve me përkatësi etnike shqiptare në polici dhe ushtri që jo vetëm fituan në përparësi, por që në të njëjtën kohë ishin të definuara me precizitet në tekstin e Marrëveshjes. Ligjet për dokumentet personale (Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për letërnjoftimet, 2004) dhe vendosja e gjuhës shqipe në to, poashtu përbënin ndryshime që kishin ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të qytetarit dhe jetës së tij të organizuar institucionale, për të vazhduar mandej me ligjin për arsim të lartë (Ligji për arsimin e lartë, 2003), me të cilin u bë zyrtar përdorimi i gjuhës shqipe në universitetet shtetërore, që solli si rezultat njohjen zyrtare të Universitetit të Tetovës dhe më vonë themelimin e Universitetit Nënë Tereza në Shkup. Rrjedhimisht, gjatë periudhës 2002-2008, praktikat e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe përfshijnë përdorimin në parlament dhe në qeverisjen lokale, gjithnjë duke pasur parasysh faktin që flasim për zyrtaritet të gjuhës shqipe në nivel të të folurit shqip, por jo edhe në nivel të të shkruarit shqip.

Çështja e dallimit në mes gjuhës së shkruar dhe asaj të folur, bën ndryshimin esencial kur flasim për përdorimin zyrtar të një gjuhe në kuptimin shoqëror por edhe politik. Megjithatë ky dallim ka aspektet e veta linguistike që janë aktuale që nga periudha e shkrimeve të Aristotelit për retorikën e deri në ditët e sotme, kur ai thekson: Duhet ditur

që secila retorikë ka stilin e vet të veçantë. Stili i prozës së shkruar nuk është i njëjti me atë të oratorisë së folur (Aristotle, 2018:33). Kjo pikëpamje bëhet interes i veçantë studimor, kur kemi parasysh faktin që ky mendim aristotelian i dedikohet pikërisht përdorimit të gjuhës në publik, pra një përdorimi të gjërë dhe jo privat. Dhe kur flitet për këtë aspekt të përdorimit publik të një gjuhe, aspekti i dallimit ndërmjet gjuhës që flitet dhe asaj që është e shkruar ka dimensionet e veta funksionale dhe kontekstuale. Analizat dhe studimet e ndryshme, nënvizojnë pikërisht faktin që në krahasimet e bëra të fjalimeve të mbajtura nga katër presidentë të ndryshëm të SHBA-ve, ka dallime të dukshme në gjuhën e fjalimit të mbajtur në publik nga gjuha e të njëjtit fjalim kur është i botuar dhe i lexuar. Sepse: gjuha në formën e vet të shkruar mund të mblidhet, të ruhet, të kontrollohet, hulumtohet dhe analizohet, në një formë që deri në ditët tona nuk ka qenë e mundshme të bëhet me gjuhën e folur (Wallace&Tanen, 1986:23). Dhe kur jemi tek gjuha e folur në këtë katërvjeçar të parë pas Marrëveshjes së Ohrit në nivel të pushtetit qendror, ishte sfidues përdorimi i saj në kuptimin e mungesës së përkthyesve, mungesës së trainimit të përkthyesve, problemeve reale me përdorimin e terminologjisë, thjesht përdorimin e një gjuhe si formë të shprehjes jo vetëm të identitetit gjuhësor të shqiptarëve, por njëkohësisht si formë e shprehjes së identitetit politik dhe shoqëror të tyre.

3. DREJT NJË LIGJI TË VEÇANTË PËR PËRDORIMIN E GJUHËS SHQIPE

Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe në periudhën 2002-2008 bazohet në kushtetutën e ndryshuar dhe ligje të caktuara që u ndryshuan si rezultat i Marrëveshjes së Ohrit dhe që në mënyrë të pjesëshme përfshinin edhe përdorimin e gjuhës(dokumentet personale, universiteti, regjistrimi i popullsisë, ligjet për qeverisjen lokale), pra është fjala për përdorim të një gjuhe por pa pasur një ligj i cili do të vendoste korniza më të sakta dhe më të qarta për të përdorur gjuhën shqipe institucionalisht.

Duke qenë se secili ndryshim në nivelin e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe ishte ngushtë i lidhur me kontekst të caktuar politik, edhe ligji i parë për përdorimin e gjuhëve i votuar nga parlamenti në vitin 2008 erdhi si rezultat i drejtpërdrejtë i formimit të qeverisë së re politike e cila pasoi marrëveshjen politike të Majit të vitit 2007. (Shpjegim: Marrëveshja e Majit është marrëveshje politike e përbërë nga 5 pika, mes partive politike BDI dhe VMRO-DPMNE. Palët në këtë marrëveshje janë dakorduar për të kaluar në parlament Ligjin për përdorimin e gjuhëve si dhe përcaktimin e një liste të ligjeve të cilat votohen me shumicë të dyfishtë (Votimi i quajtur si Badenter).

Me aprovimin e këtij ligji përcaktohet përdorimi i gjuhës shqipe në parlament, gjykata, procedura zgjedhore, avokati i popullit, komunikimi me ministritë, veprimtaria radiodifuzive, objektet infrastrukturore, qeverisja lokale, finansat, ekonomia, shkenca dhe arsimit, kultura dhe fusha të tjera të përfshira me këtë ligj.(Ligji i përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Qeverisjes Lokale, 2008). Kur shikohet me kujdes teksti i këtij ligji, nuk mund të mos lexohet brenda tij konteksti politik i sjelljes së këtij ligji dhe të mos kuptohet fryma e negociatave për të. Pra është fjala për ligj i cili përcakton dhe konkretizon edhe më tej sferat e përdorimit të gjuhës shqipe, por në kuptimin e përdorimit zyrtar, në parlament ajo mbetet akoma në nivelin e gjuhës së folur, me materiale të përkthyer në gjuhën shqipe vetëm nëse për të njëjtat ka kërkesë nga deputeti gjatë procedurave parlamentare. Ky ligj do të pësojë edhe një ndryshim në vitin 2011(Ligji i përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Qeverisjes Lokale, 2011) me të cilin ndryshim parashihet dhe mundësohet udhëheqja me trupat punues të parlamentit edhe në gjuhën shqipe. Në këtë ligj edhe pse numërohen institucionet me mundësi të përdorimit të gjuhës shqipe, megjithatë në institucionet e pushtetit qendror nuk parashihet mundësia e përdorimit të gjuhës shqipe, ashtu siç nuk mund të përdoret as në seancat e qeverisë dhe mbishkrimet e institucioneve të pushtetit qendror. E drejta për përdorim të gjuhës shqipe sipas këtij ligji nuk është një e drejtë dhe obligim institucional për përdorimin e gjuhës shqipe, por është e drejtë individuale e personit që në komunikimin e tij me institucionin përgjigjen eventuale nga institucioni ta marrë në gjuhën shqipe. Dhe ky moment është problemi më i madh i këtij ligji, i cili në studimet krahasimtare konsiderohet si standard më i ulët se Karta Europiane për Gjuhët Rajonale dhe të Pakicave. (Kadriu&Sela, 2017:13). Që ky ligj ishte i pamjaftueshëm dhe nuk plotësonte standardet e parashikuara nga Marrëveshja e Ohrit konstatohet edhe në Analizën mbi Realizimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe kohezionit social, realizuar nga Sekretariati për Marrëveshje të Ohrit në kuadër të Qeverisë së RM. Sipas këtij teksti korniya ligjore bazohet në interpretim restriktiv të të drejtave gjuhësore dhe rekomandon sjellje të një ligji të ri për përdorimin e gjuhës shqipe, ligj i cili do të qartësonte amandamentin e V-të të kushtetutës.(OFA Review, 2015:4).

Kur flasim për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe në RMV, gjithnjë duhet mos harruar fakti që definimi i zyrtaritetit të kësaj gjuhe është rezultat direkt i një revolucionit të mandej i hedhur në letër si Marrëveshje e Ohrit, por rruga vendosjes së gjuhës shqipe në kornizat e duhura ligjore, ishte dhe vazhdon të jetë pjesë e një procesi evolutiv, proces ky i cili nuk përfundon edhe me Ligjin e ri të përdorimit të gjuhëve i aprovuar në vitin 2019, meqë gjuha është pjesë e dinamikës zhvillimore të një shoqërie.

Ligji i propozuar nga Qeveria e RMV në vitin 2017 dhe i aprovuar në vitin 2019 është rezultat i drejtpërdrejtë i një konteksti të ri politik në vend, ndryshimet në skenën politike të cilat sollën edhe Marrëveshjen e Prespës me Greqinë

dhe u pasuan me anëtarësimin e vendit në NATO. Ky ligj në fazën e propozimit të tij u bë pjesë e Programit Nacional për anëtarësim në BE dhe si i tillë në procedurë kuvendore hyri si pjesë e legjislativit që ka të bëjë me proceset e anëtarësimit në BE.

Me ligjin e ri të përdorimit të gjuhëve, ridefinohet plotësisht përdorimi zyrtar duke u definuar se kjo gjuhë që flitet nga më së paku 20% e qytetarëve bashkë me alfabetin e saj, është zyrtare në gjithë territorin e vendit si dhe në të gjitha organet qeveritare dhe institucionet e tjera të cilët ushtrojnë funksion publik. (Sela, Shasivari, Saliu, Zejneli, Hajretin, Matovski, 2021:32) Poashtu, përveç qeversijes lokale dhe parlamentit si institucione të vetme të apostrofuara për përdorim zyrtar të gjuhës shqipe në ligjet paraprahe, në këtë ligj përcaktohet dhe definohet përdorimi i gjuhës shqipe në qeveri dhe trupat punuese të qeverisë, institucionet publike – përfshirë emërtimet e institucioneve dhe përdorimin e gjuhës shqipe, raportet fiskale, pullat postale, faturat e institucioneve pagesore publike, gjykatat dhe organet e përmbarimit, noteriatit dhe zbatimit të sanksioneve si dhe shkruarjen në gjuhën shqipe të shesheve, kalimeve kufitare që bëjnë pjesë në rajonet ku përdoret gjuha të cilën e flasin mbi 20% e popullatës së vendit (Ligji për përdorimin e gjuhëve, 2019:1).

I një rëndësie të veçantë është fakti që me anë të këtij ligji parashihen dhe vendosen në funksion institucionet zyrtare që kanë për qëllim promovimin, mbrojtjen dhe zbatimin uniform të gjuhës shqipe edhe atë: Agjencia e zbatimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të RMV si dhe Inspektorati i përdorimit të gjuhëve. Për sa i përket funksionimit të Inspektoratit si institucion i cili duhet të monitorojë realizimin e dispozitave të këtij ligji në praktikë, menjëherë pas aprovimit të Ligjit për gjuhën, aprovohet edhe zgjidhje ligjore sa i përket funksionimit të këtij institucioni të rëndësishëm kontrollues. (Ligji për Inspektoratin për përdorimin e Gjuhëve, 2019). Me funksionalizimin e këtyre institucioneve të parapara me ligj, përfundimisht sigurohet aspekti i përdorimit zyrtar dhe përkujdesja institucionale sa i përket përdorimit të gjuhës shqipe.

4. SHËNIME PËRMBYLLËSE: LIGJ I RI, SFIDA TË REJA

Ashtu siç edhe theksuam në shënimet hyrëse, bërja e gjuhës shqipe gjuhë në përdorim zyrtar ishte dhe mbetet një angazhim kolektiv dhe ideal i lartë shoqëror dhe shtetëror i shqiptarëve në Maqedoni dhe formë identitare e padiskutueshme në formimin kolektiv. Duke u nisur nga fakti që pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Maqedonisë në vitin 1991 dhe suprimimit të përdorimit de jure të gjuhës shqipe, janë tre dekada angazhim dhe përpjekje për të vendosur gjuhën shqipe në përdorim jo vetem *de jure* por edhe në jetën dhe funksionimin e rregullt të të gjitha institucioneve publike në vend. Poashtu, në kuptimin identitar gjuha mbetet ajo epiqendër kyçe për ndërtimin dhe mbajtjen e identitetit kolektiv të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut dhe si një identitet i formësuar ka krijuar qëndrueshmërinë dhe rezistencën ndaj siç do të shprehej Brubaker koncepteve nacionalizuese etnike. (Brubaker, 1996). Duke pasur parasysh karakterin kontekstual të bashkësive etnike në përgjithësi (Horowitz, 1985) dhe aspektin e institucionalizimit të këtyre identiteteve të rëndësishme në veçanti (Balibar & Wæver, 2000), rregullimet kushtetuese dhe ligjore të përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe janë vijat e vendosjes në praktikë të teorive identitare për sa i përket funksionimit të më shumë identiteteve gjuhësore brenda një kornize kushtetuese. Një realitet kaq i njohur dhe i pranuar në legjislativin e institucioneve të përbashkëta të BE-së, në të cilat shumëgjuhësia si një realitet evropian bëhet një praktikë reale (Moren, 2001).

Duke u nisur nga kjo besnikëri e padiskutueshme ndaj këtij identiteti gjuhësor, apo ajo lidhje e pandashme me kulturën kombëtare e cila krijon bazën emotive të kombit (Banac, 1984:12), shqiptarët Maqedonisë së atëhershme edhe në vitin 1972 në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë përqafuan gjuhën standarde letrare shqipe, ashtu edhe sot mbeten në qëndrimin e përdorimit të një gjuhe standarde shqipe. Por, sot, sfida institucionale e shkencës për gjuhën shqipe në Maqedoni është shumëfish më e madhe, duke pasur parasysh që sfera e përdorimit të gjuhës shqipe është zgjeruar shumëfish ashtu siç janë rritur dhe krijuar më shumë kapacitet dhe mundësi akademike për studimin dhe mirëmbajtjen e shqipes si gjuhë në përdorim shumë më të gjerë sesa në ndonjë kohë tjetër.

Sfidë tjetër në këtë drejtim përbën fakti që me ligjin për përdorim të gjuhëve nga viti 2019, parashihet përdorim i shqipes në sfera publike në të cilat nuk kemi pasur përdorim më parë, gjë që nënkupton edhe dobësi sistimore në jetësimin e këtij ligji. Prandaj, është i vlerës strategjike bashkëpunimi i universiteteve në vend me qëllim të plotësimit të këtyre kapaciteteve si dhe përfshirja e gjuhës shqipe si gjuhë pune në fakultetet dhe universitetet në përgjithësi dhe jo vetëm në fakultetet filologjike.

Një analizë për përdorimin zyrtar të një gjuhe pa diskutim që do të përfundonte me hipotezën e Sapir-Whorf mbi natyrën e gjuhëve të ndryshme dhe mbi relativitetin gjuhësor. Pra, qeniet njerëzore nuk jetojnë të vetmuar në këtë botë objektive... por janë në mëshirën e asaj gjuhe të veçantë që është mjet shprehjeje në shoqërinë e tyre. Këtë gjuhë përbëjnë botëra të ndara dhe jo një botë me etiketa të ndryshme në dyert e hyrjes. (Lucy, 2001; Blackburn, 2022) Që do të thotë se janë të ndryshme botërat e gjuhëve tona, por është vlerë civilizuese të gjejmë mënyrën për tu kuptuar në gjuhët tona të ndryshme në këtë kohë kur globalizmi gjuhësor do na krijojë temën për diskutimin e rradhës.

BIBLIOGRAFIA

- Aristotle, (2018), *The Art of Rhetoric*, Oxford World's Classics;
- Andeva, M., & Sela, Y., & Matovski, L., (2022), Languages and Identities in North Macedonia: Legal and Political Challenges to State Formation, *MPRA Paper* No.116695, <https://mpra.ub.uni-muenchen.de.>;
- Balibar, E. & Wallerstein, I. (2000) *Race, Nation, Class, Ambiguous Identities*, London-New York, Verso;
- Balibar, E. (2001), *Nous, Citoyens D'Europe? Les frontieres, l'Etat, le peuple*, Editions La Decouverte, Paris;
- Banac, I. (1984), *Nacionalno Pitanje u Jugoslaviji, Porijeklo, Povijest, Politika*, Zagreb, Globus;
- Blackburn, S. W. (2022), The philosophy of language, Sapir-Whorf hypothesis, *Encyclopedia Britannica, Category: history and society*, <https://britannica.com>;
- Brubaker, R. (1996), *Nationalism reframed, Nationhood and the National Question in the New Europe*, Cambridge University Press;
- Hagege, C. (1992), *Le souffle de la langue*, Paris, Editions Odile Jacob;
- Horowitz, D. L. (1985), *Ethnic groups in conflict*, University of California Press;
- Kadriu, B., & Sela, Y., (2017), *The right to use Albanian Language as an official Language in Macedonia: the new Draft Law, its content, advancement and comparison*, *International Journal of Bussines and Technology*, Vol 6.; pp.2-16, <http://knowledgecenter.ubt-uni.net>;
- Ligji i përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Maqedonisë dhe në njësitë e Vetëqeverisjes Lokale, (2008), *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr. 101/2008;
- Ligji për ndryshimin e këtij Ligji, (2011), *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr.100/2011;
- Ligji i përdorimit të gjuhëve, (2019), *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. 7/2019;
- Ligji për inspektoratin për përdorimin e gjuhëve, (2019), *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, nr. 220/2019;
- Ligji për Letërnjoftim, (2004), *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr. 16/2004;
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Arsimin e Lartë, (2003), *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr. 49/2003;
- Lucy, J.A. (2001), Sapir-Whorf Hypothesis, *International Encyclopedia of the Social & Behavioral Science, Pergamon*, pp.13486-13490, doi.org.10.1016/B0-08-043076-7/03042-4;
- Morin, E. (2001), *Europa në Mendje*, Tiranë, Libra për shoqëri të hapur;
- Ragaru, N. (2008), Macedonia: Between Ohrid and Brussels, *Cahiers de Chaillot*, N. 107, pp. 41-60; hal-00972853, <https://sciencespo.hal.science>;
- Ohrid Framework Agreement*, (2001), <https://www.osce.org>;
- Ohrid Framework Agreement, Annex B, Legislative modifications* (2001), <https://www.osce.org>;
- Ohrid Framework Agreement Review on Social Cohesion*, (2015), European Institute of Peace, Skopje, www.eip.org;
- Shapiro, M. J. (2016), *Politics and time*, London, Polity;
- Sela, Y. & Zejneli, J. & Shasivari, J. & Hajretin, V. & Salii, A. & Matovski, L. (2021), *Gjuha Shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019*, Shkup, Agjencia e zbatimit të gjuhës;
- Sela, Y., & Matovski, L., (2022), *Legal Aspects of Use of Languages in Republic of North Macedonia*, Skopje, Language Implementation Agency of RNM;
- Wallace, Ch., & Tanen, D. (1987), The relation between Written and Spoken Language, *Annual Review of Anthropology*, vol 16, pp 383-407, <https://www.jstore.org>;